



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 38  
Prishtinë, më 29 mars 2019, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Avdullah Hoti, Albert Kinolli, Emilija Rexhepi, Etem Arifi, Valon Ramadani dhe Ali Lajçi.

**Munguan:** Andin Hoti, Verica Ceraniç dhe Faton Topalli.

**Stafi mbështetës:** Mehmet Simnica, Antigona Ibraj , Ajet Avdullahu dhe Aurel Haxhiu.

**I ftuar:** Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi.

**Pjesëmarrësit tjerë:** Kujtesa Bajrami Fana nga RTV 21, Faruk Rrahmani, Arvita Zyferi dhe Violeta Smajlaj nga ZKA, Shpend Gashi nga KDI.

**Mbledhjen e kryesoi:** Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 22.02.2019;**
3. **Shqytimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 dhe Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018, i ftuar Sekretari i Pergjithshëm z.Ismet Krasniqi;**
4. **Mbikqyrja e zbatimit të Ligjit Nr.06/L021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;**
5. **Të ndryshme.**

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.02.2019**

*Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 22.02.2019, u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqytimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 dhe Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018**

**Kryetari** prezantoi raportin e auditimit për vitin 2017 për Kuvendin e Kosovës. Ai tha se kjo nënkupton se pasqyrat financiare për vitin 2017 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Në raport me vitin e kaluar janë vërejtur përmirësime të menaxhimi i pasurive. Po ashtu, gjatë vitit 2017 niveli i realizimit të buxhetit final nga ajo që ishte planifikuar sillet rreth 91%. Kryetari theksoi se nga 11 projekte të buxhetuara vërehet se në nëntë prej tyre nuk ishte shpenzuar fare buxhet, kurse në dy projektet tjera kishte një realizim të ulët pasi që as fondet e tyre nuk ishin shpenzuar plotësisht. Gjithashtu ai përmendi edhe subvencionimin e OJQ-ve “Lidhja e Invalidëve dhe Viktimave të Luftës” në shumë 2,000 euro dhe “Klubi Alpina” në shumë 5,000 euro që ishte bërë me qëllimin e përkrahjes së tyre e më pas përkundër përfundimit të projekteve, OJQ-të e subvencionuara nuk kishin dorëzuar raportin final të shpenzimit të mjeteve deri në prill 2018 edhe pse këto projekte kishin përfunduar në mars 2017 dhe korrik 2017. Kryetari përmendi edhe mangësitë në definimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, rasti në dosjen e tenderit për projektin “Sistemi i menaxhimit të objektit”, te kriteri për kapacitetet teknike dhe profesionale Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar që njeri nga inxhinierët duhet të ketë certifikatën nga njëri prej kurseve. Operatori Ekonomik përkundër faktit se e kishte ofruar këtë certifikatë, komisioni i vlerësimit e kishte shpallur si të papërgjegjshëm me arsyetimin se nuk ishte certifikata e duhur. Më pas ky tender ishte anuluar dhe ri-tenderuar. Në procesin e ri-tenderimit ishte shkuar me konkurs të projektimit ku përveç kriterëve tjera ishte vendosur përsëri kriteri për certifikatën nga njëri prej kurseve dhe OE i njëjtë me të njëjtën certifikatë herën e dytë ishte shpallur fitues dhe kishte nënshkruar kontratën në vlerë prej 25,800 euro. U cek edhe raporti i auditimit për PFV-të e Kuvendit për vitin 2016 ku ka rezultuar në dy rekomandime. Kuvendi kishte përgatitur me kohë një plan veprimi, ku kishte paraqitur detajet e masave dhe aktivitetëve se si do të i zbatojë rekomandimet e dhëna. Nga dy rekomandimet e dhëna njëri ishte zbatuar ndërsa rekomandimi për migrimin e pasurive të blera para vitit 2011 në sistemin e-pasuria ishte në proces të zbatimit. Po ashtu, në raport janë të dhëna tri rekomandime. Kuvendi është pajtuar me përmbajtjen e raportit dhe është zotuar se do të i zbatojë të gjitha rekomandimet.

**Sekretari** tha se projektet kanë ngecur në vitin 2017 për shkak të procedurave strikte dhe të tej zgjatura që janë me Ligj të Prokurimit Publik dhe për këtë ka pasur vonesa. Ai tha se çdo shpenzim i Kuvendit realizohet në bazë të vendimeve, asnjë nuk ndodh të veproj pa një kontroll strikt të brendshëm deri sa ta dinë se mjetet janë arritur në vendin e paraparë. Sekretari u shpreh se subvencionet shkojnë në destinacionin e nisur dhe nuk ka problem asnjëherë edhe pse ekzistojnë vonesat. Deri sa ka një kod ekonomik për të zbatuar këtë pozicion, Kryesia e Kuvendit ka nxjerrë

rregullore për subvencion dhe transfer në çdo aspekt është i përmbyllur me buxhet dhe rregullore për zbatim të buxhetit. Ai pranoi se ka ardhur një raport por me vonesë dhe është përmbyllur investimi i paraparë.

**Ali Lajci**, kërkesa për këtë mbledhje është shumë me vend pasi që kemi një raport për shkak të krahasimeve që mund të bëhen në shpenzimet pas pasqyrave buxhetore, kemi edhe disa shpenzime kapitale të cilave fatkeqësisht iu është dhënë në fund të mandateve. Shpenzimet kapitale, subvencionet këto kanë ngecje për shkak të procedurave që parashihen me Ligj të Prokurimit Publik.

**Kryetari**, meqenëse nuk pati të interesuar tjetër për të diskutuar për këtë pikë Kryetari vazhdoi me diskutimin sa i përket Raportit të Shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2018. Ai theksoi se problemi i njëjtë vërehet edhe në vitin 2018. Niveli i ulët i shpenzimeve është në investimet kapitale, nga 1,486,000 euro sa ishin buxhetuar fillimisht, është zbritur në 195,000 dhe janë realizuar 154,000 ose 78%. Në emër të subvencioneve nga totali i shpenzimeve 128,000 euro për entitete publike, janë shpenzuar 91 mijë euro, ndërsa për entitete jopublike 36 mijë euro ku e konsideroi si të mangët këtë informacion pasi që nuk tregon përfituesit. Po ashtu, shpenzimet në nivel të pagave dhe mëditjeve për muajt tetor, nëntor, dhjetor dhe ka një dallim për muajin tetor janë ndarë 68,435 euro, për muajin nëntor afërsisht 68,000 por në muajin dhjetor shkon vlera 110,000. Për 3 muaj vetëm për paga mëditje, shpenzime për udhëtime jashtë vendit, udhëtime zyrtare, shpenzime për telefoni ky program harxhon 310,000 euro. Dallimi nga viti 2017 në stafin mbështetës politik vetëm në paga mëditje është 347,000 euro, kurse në total ku përfshihen edhe mallrat dhe shërbimet është 420,000 euro. Pasqyrat për vitin 2018 theksoi se janë shumë të paqarta ku numëroi disa kompensime. Gjithashtu, problem tjetër është edhe tek automjetet e marrura me qera, operatori ekonomik ka bërë padi në gjykatë për veturat të cilat atë kohë nuk janë pranuar as shfrytëzuar nga Kuvendi. Nuk është plotësuar numri i punëtorëve në Kuvend nga 361 sa punojnë aktualisht në dallim prej numrit të lejuar të të punësuarve prej 394. Furnizimi me laptop për deputet, ku nuk figuron çmimi për njësi dhe sasia e laptopëve.

**Sekretari**, njoftoi deputetët e komisionit dhe të pranishmit se Kryesia e Kuvendit ka dhënë shpjegim që në momentin kur Komisioni për Buxhet dhe Financave ta miratoi Raportin e Shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2018, atëherë Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike mund ta shqyrtoj atë. Kështu që Sekretari vendosi të respektoj Vendimin e Kryesisë së Kuvendit.

**Avdullah Hoti**, theksoi se qëndrimi i Sekretarit të Kuvendit për tu mos u përgjigjur në pyetje e parashtruara për raportin e shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2018 është një rast i paprecedentë. Kjo nuk duhet të tolerohet!

### *Përfundim*

*KMFP vendosi që Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017, të mos adresohet për në Seancë Plenare ndërsa raporti i Shpenzimeve për vitin 2018, të trajtohet në Komision pasi të miratohet paraprakisht nga Komision për Buxhet dhe Financa.*

#### **4. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr.06/L021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike**

**Kryetari**, ne kemi ndërmarrë disa hapa për kontrollin e brendshëm të financave publike ku sot duhet të miratojmë planin e punës që kemi përgatitur për monitorim, kemi vendosur të mos përjashtojmë deputet nga grupi punues por i gjithë Komisioni të jetë. Është përgatitur një agjendë nga administrata ku do të vizitohen Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komuna e Prishtinës, Komuna e Fushë Kosovës, Komuna e Lipjanit, Komuna e Podujevës, Komuna e Suharekës.

**Emilija Rexhepi**, tha se do të sugjeroja që në listës të përfshihet edhe Komuna e Prizrenit pasi që ka probleme me auditor.

#### *Përfundim*

*KMFP, vendosi që të aprovon planin e punës për monitorimin e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike sipas planit të përgatitur nga administrata e komisionit dhe listës së Institucioneve të i shtohet edhe Komuna e Prizrenit.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit**

**Kryetari i komisionit,**  
\_\_\_\_\_  
**Driton Selmanaj**